



BULETINI MJEDISOR

Numri # 5 (Dhjetor 2011)

Abonohu në: www.ks.undp.org

NË KËTË NUMËR

LAJME NGA VENDI

- Arti i mbeturinave
- Alpinizimi dhe ekoturizmi
- Mbrohet mjedisit dhe ndihmohen të papunët
- Konferencë për menaxhimin e mbetjeve industriale të kompleksit Trepça
- Në Malishevë zbulohet edhe një shpellë

LAJME NGA BOTA

- Qëndrueshmëria dhe barazia kyçe për të ardhme më të mirë
- Atlasi i ri i globit, prezantohen efektet e ngrohjes globale

I nderuari lexues,

Në prag të këtij fundviti po sjellim tek ju edhe një numër të Buletinit Mjedisor. Duke mbetur me shpresë që gjatë këtij viti përmes Buletinit tonë informativ kemi sjellë tek ju informacione me interes në sektorin e mbrojtjes së mjedisit, ne do të bëjmë përpjekje që në të njëjtën frymë të vazhdojmë edhe vitin tjetër. Edhe në këtë numër Buletini Mjedisor i mbetet besnik formatit të temave të përzgjedhura dhe informacioneve të ofruara që prekin ngjarje dhe aktivitete nga grupe të ndryshme në regjione të ndryshme të Kosovës. Me këtë rast falënderojmë edhe njëherë të gjithë ata që kontribuuan dhe ndihmuan në publikimin e Buletinit Mjedisor përmes informacioneve dhe temave të ofruara dhe i ftojme dhe i inkurajojmë për forcimin e këtij bashkëpunimi edhe në vitin e ri. Urojmë që viti i ri 2012 të jetë, vit i përpjekjeve, angazhimeve dhe aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e gjendjes së tij.

Ekipi Redaktues

ARTI I MBETURINAVE

Menaxhimi efikas i mbeturinave është njëri ndër problemet më të mëdha mjedisore në Kosovë. Aktualisht pjesa më e madhe e mbeturinave shkon nëpër deponi, kurse një pjesë e vogël e tyre ripërdoren dhe riciklohen. Megjithatë ka iniciativa të ndryshme sidomos nga bizneset private për ndarjen, riciklimin e mbeturinave dhe ripërdorimin e tyre. Në kuadër të këtyre përpjekjeve ka edhe iniciativa individuale për sensibilizimin e opinionit për të punuar më shumë për menaxhimin mbeturinave. Një gjë të tillë është duke e bërë Skënder Boshnjaku. Edhe pse me profesion mjek neuropsikiatër, ai krahas mjekësisë është marrë edhe me vlerësime të ekspozitave pamore që nga viti 1974. Interesimi i tij është fokusuar në tema të grafitëve, artit urban dhe në heraldikë. Por e veçanta e artit të tij është një cikël i punimeve të titulluar 'Eco&Garbage Art', në të cilin ka shfrytëzuar mbeturinat për të krijuar punime artistike. Përveç faktit se punimet e tij janë

shumë origjinale, të veçanta dhe të rralla, ato bartin edhe porosinë se si mundë të kontribuojnë artistët në sensibilizimin e opinionit për mbrojtjen e mjedisit. Për punën e tij të veçantë dhe kontributin për mbrojtjen e mjedisit përmes artit të mbeturinave Skënder Boshnjaku është nderuar edhe me mirënjohjen "Ambasador nderi i mjedisit" nga lëvizja mjedisore Bells.





**INFORMATA
TË
PËRMBLEDHURA**

◊ Deri me tani në Kosovë janë evidentuara 21 shpella me vlera natyrore. Vetë 7 prej tyre aktualisht janë të mbrojtura me ligj.

◊ Në territorin e Kosovës janë identifikuar rreth 110 lokacione si pika të ndjeshme mjedisore, ndërsa si zona me potencial më të madh ndotës të njohura si hot-spote mjedisore janë evidentuar 28 sosh.

◊ Sasia më e madhe e pesticideve në Kosovë përdoret në sektorin e Bujqësisë rreth 89%, në sektorin e Blegtorisë dhe Veterinarisë 3.5%, në sektorin e Higjienës Komunale 3.3 % dhe në sektorin e Industrisë së ushqimit rreth 3%.

ALPINIZIMI DHE EKOTURIZIMI

Në kuadër të përpjekjeve për promovimin e turizmit malor, në komunën e Pejës kohë me parë është hapur Qendra për Edukim të Qëndrueshëm Malor. Qendra ka selinë në Mullirin e Haxhi Zekës, që është monument kulturor e historik, e që për objektiv kryesor ka promovimin e vlerave të trashëguara natyrore dhe kulturore në Rrafshin e Dukagjinit. Kosova ka potencial për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit malor mendon Fatos Lajçi prej OJQ mjedisore ERA.



Foto nga ERA

ERA mundohet të promovojë vendosjen e bilancit delikat midis zhvillimit të qëndrueshëm të ekoturizmit dhe praktikave të mira për mbrojtjen e mjedisit të cilin e eksplorojmë. Në programet e tyre edukative për mjedisin, OJQ ERA, përhap njohurit rreth qasjes 'Atë çka sjellë, merre me vetë' dhe 'Mos lë gjurmë' që ka për qëllim sensibilizimin e vizitorëve të mos lënë mbrapa mbeturinat dhe të mos dëmtojnë natyrën.

Iniciativa e ERA's është shembull i mirë për investim në zhvillimin e turizmit malor. Fatos Lajçi dëshiron të shoh mbeshtetje më të madhe institucionale për promovimin e turizmit të qëndrueshëm. Komuna e Pejës ka mirëpritur këtë iniciativë. I tërë qëllimi është që të shfrytëzohet potenciali që ka kjo komunë për të zhvilluar turizmin dhe për të integruar komunitetin në zhvillimin e tij.

MBROHET MJEDISI DHE NDIHMOHEN TË PAPUNËT

Në komunën e Kaçanikut po zbatohet një projekt për mbrojtjen e mjedisit i cili gjithashtu ka edhe karakter social. Projekti "Largimi i mbeturinave nga deponitë ilegale dhe pastrimi i shtretërve të lumenjve", po financohet nga Banka Botërore në kuadër të programit të punëve publike të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe përveç përmirësimit të gjendjes së mjedisit ka për qëllim edhe gjenerimin e punësimi dhe zbutjen e varfërisë. Në kuadër të projektit fillimisht është bërë pastrimi i shtratit të lumit Neredime në rrjedhën e tij që kalon nëpër qytetin e Kaçanikut, ndërsa më pastaj do të vazhdohet edhe me pastrimin e pjesës tjetër të shtratit të lumit dhe me heqjen e deponive ilegale të mbeturinave në qytet. Projekti ka vlerën rreth 52 mijë euro dhe 60 % e mjeteve janë të dedikuara për pagat e 47 të punësuarve në

këtë projekt. 70 % e punëtorëve të angazhuar në projekt janë përzgjedhur nga lista e punëkërkuarve të Zyrës Komunale të Punësimi me gjendje të rëndë sociale, ndërsa 30 % janë punëtorë të kompanisë së kontraktuar për kryerjen e punimeve. Ky projekt është një shembull shumë i mirë se si mundë të bëhet më shumë për mbrojtjen e mjedisit nëpër komunat e Kosovës duke përkrahur edhe punësimin.




SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT!

♻️ Qëndro në dush më pak, kurse paratë dhe ujin.



♻️ Përdori pajisjet e amvisërisë me efikasitet. Enëlarësen dhe rrobalarësen mbushe përplot.



♻️ Vozit më ngadalë për të pakësuar gazrat. Vozitja agresive konsumon më shumë karburant.



**KALENDARI
MJEDISOR**

2 SHKURTI

Dita botërore e kënetave

21 MARS

Dita botërore e pylltarisë

22 MARS

Dita botërore e ujit

23 MARS

Dita botërore e meteorologjisë

26 MARS

Ora e tokës

7 PRILLI

Dita botërore e shëndetit

22 PRILLI

Dita e tokës

KONFERENCË PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INDUSTRIALE TË KOMPLEKSIT TREPÇA

Dikur, Kompleksi i Minierave dhe Metalurgjisë i Trepçës ka qenë boshti kurrizor i ekonomisë së Kosovës, ndërsa minierat ishin industria kryesore e Kosovës. Trashëgimia e një sasive të madhe të mbeturinave industriale toksike, rrjedhjeve acidike dhe pluhurit përbëjnë kërcënim serioz për popullsinë që jeton aty pranë. Për t'i trajtuar këto çështje, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Komuna e Mitrovicës dhe Kompania Trepça në partneritet me dhe me përkrahje nga UNDP organizuan Konferencë për menaxhimin e mbetjeve industriale për kompleksin e Trepçës.

Qëllimi i konferencës ishte të sigurohej prioritet më i lartë për problemet mjedisore të Trepçës brenda agjendës së përgjithshme politike dhe zhvillimore të Kosovës. Konferenca ka ofruar mundësi për shkëmbim të njohurive dhe për të kuptuar ndikimin negativ të mbeturinave industriale në mjedis dhe shëndetin e njeriut, shkëmbimin e përvojave më të mira për rehabilitim të deponive dhe ndërlikohen e këtyre veprimeve me zhvillimin ekonomik, aprovimi i një sërë masash të menjëhershme dhe afatgjata, arritja

e pajtimit për një plan të përbashkët veprimi për të krijuar struktura formale koordinuese mes aktorëve të zhvillimit, institucioneve dhe industrisë që u përcaktuan nga palët e interesit.


Pjesëmarrësit në konferencë pranuan se Kosova nuk meriton zhvillim të bazuar në të menduarit "së pari zhvillo ekonominë pastaj pastro", por ka nevojë për ekonomi të fortë dhe të qëndrueshme.

Prandaj, strategjia për të trajtuar çështjet komplekse për Trepçën është e nevojshme dhe urgjente. Ekonomia e Kosovës dhe shëndeti publik në të ardhmen do të mbështeten fuqimisht tek një strategji e tillë, që duhet të trajtojë disa nga kushtet më të këqija shëndetësore dhe të jetesës në Evropë, të çlirojë kapitalin njerëzor, të gjenerojë punë dhe të përmirësojë padrejtësinë sociale të trashëguar.

Në përfundim të konferencës, palët u pajtuan për veprimet vijuese duke përmbledhur rekomandimet nga konferenca dhe duke zhvilluar e prioritetizuar listën e ndërhyrjeve të menjëhershme dhe afatgjate.

NË MALISHEVË, ZBULOHE EDHE NJË SHPELLË

Në territorin e Komunës së Malishevës është zbuluar edhe një shpellë. Shpella ndodhet në perëndim të fshatit Temeçinë, në lartësi mbidetar 638 m. Një ekip i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka vizituar këtë lokalitet dhe ka hyrë në shpellë për të evidentuar gjendjen e vlerave natyrore të shpellës. Në hyrje të shpellës gjenden dy korridore, njeri korridor vazhdon në perëndim me gjatësi rreth 10 m, ndërsa korridori kryesor zbrit në thellësi rreth 4 m. Ky korridor është i pasur me stalaktitet dhe stalagmite, ndërsa, dysHEMEJA e korridorit është e pasur me kristale kalciumi që kanë një ngjyrë të kuqërremtë. Brenda në shpellë është mjaft freskët dhe temperaturat janë të ulëta, aty vazhdimisht pikon uji nga kristalet. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në bashkëpunim me Komunën e Malishevës e ka evidentuara këtë shpellë në regjistrin e monumenteve natyrore me vlera të veçanta natyrore dhe ka nisur procedurat për marrjen në mbrojtje ligjore të saj.





QËNDRUESHMËRIA DHE BARAZIA KYÇE PËR TË ARDHME MË TË MIRË

Pas nxjerrjes globale të Raportit të zhvillimit njerëzor 2011 në Kopenhagë, UNDP-ja në Kosovë organizoi një tryezë të rrumbullakët ku ministritë, agjencitë e OKB-së në Kosovë, palë të interesit ndërkombëtare dhe vendore si dhe përfaqësues të shoqërisë civile morën pjesë në prezantimin e raportit në Prishtinë.

Osnat Lubrani, Përfaqësuesja Rezidente e UNDP-së theksoi rëndësinë e mesazhit të Raportit të zhvillimit njerëzor për qëndrueshmëri e që nuk është një çështje ekskluzivisht mjedisore, por një çështje e drejtësisë shoqërore.

Shpetim Rudi, Zëvendësministër i mjedisit dhe planifikimit hapësinor mirëpriti gjetjet e RZHNJ-së dhe i cilësoi si relevante për kontekstin kosovar. Edhe pse të dhënat e Kosovës nuk janë të përfshira në raport, eksperti i UNDP-së e ka radhitur Kosovën sipas komponentëve që disponon IHNJ-ja, në vendet me zhvillim të lartë dhe tha se trendet globale dhe rajonale

vënë në rrezik edhe të ardhmen e Kosovës. Debati ngriti një sërë shqetësimesh të ndërlidhura me qëndrueshmërinë dhe barazinë për gjendjen aktuale të mjedisit në Kosovë, por edhe ide dhe sugjerime se si këto të trajtohen më së mirë për të parandaluar skenarët katastrofik të vitit 2050 që janë paraqitur në këtë raport.

Mesazhi i raportit deklaroi se 1,7 miliardë njerëz që janë në skaj të varfërisë nuk vuajnë vetëm nga varfëria ekonomike, por kanë edhe barrën e dyfishtë pasi vuajnë direkt degradimin mjedisor. Raporti merret me kontrollet e reja financiare dhe mjedisore të zhvillimit sfidat e qëndrueshmërisë dhe barazisë ekonomike duhet të trajtohen bashkërisht për t'iu përgjigjur nevojave finale globale global, duke shtjelluar se këto masa janë edhe me rëndësi të madhe, por edhe të mundshme dhe se.

Për numrin e radhës 06/2012, abonohu në: www.ks.undp.org

Versioni online: <http://www.kosovo.undp.org/?cid=2.176>

Ky buletin botohet në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Ekipi redaktues:

Afrim Berisha (MMPH),
Abedin Azizi (UNDP),
Inari Penttilä (UNDP)
dhe Burbuqe Dobranja (UNDP).

ATLASI I RI I GLOBIT, PREZANTOHEN EFEKTET E NGROHJES GLOBALE

Hartografët që po punojnë në përgatitjen e edicionit të ri të Atlasit bashkëkohor të botës janë detyruar të fshijnë 15% të akullit nga ishulli më i madh i globit, Grenlanda. Një zonë e këtij ishulli me përmasat e Britanisë dhe Irlandës tashmë është e gjelbër. Për këtë arsye, është dashur të hiqet në hartë shtresa dikur e përhershme e akullit, një reflektim i qartë ky i shkrirjes së akullnajave në 12 vitet e fundit si pasojë direkte e ngrohjes globale.

Atlasi përmban edhe një ishull të ri pranë brigjeve të Grenlandës, i cili quhet "Ishulli i ngrohte", që deri vonë nuk prezantohej në harta për shkak të akullit. Një sërë ndryshimesh të tjera mjedisore shfaqen në hartën e botës, përfshirë shkëputjen e masivit akullnajor Wilkins në Antarktidë dhe shembjen e urës së ngrirë që e lidhte me ishujt Charcot. Atlasi i ri tregon edhe zonat më të rrezikuara nga rritja e nivelit të detit, përfshirë këtu ishujt e Paqësorit dhe arkipelagët, ishujt në Oqeanin

Indian dhe brigjet e Afrikës, Indisë, Azisë Jug-Lindore dhe Gjirit të Meksikës. Për hartimin e tij punuan për katër vjet 30 hartografët. Ky edicion tregon po ashtu se 90% e rritjes së popullsisë së botes, që në fund të tetorit të këtij viti shënoi 7 miliardë, po vjen kryesisht nga vendet me pak të zhvilluara e sidomos nga Azia Juglindore.



SI MUND TË NDIHMONI NË MBROJTJEN E MJEDISIT!

🔄 Oxhakët tradicionale humbasin energji. Mbylle oxhakun e vatrës kur nuk e përdor.



🔄 Rregullojeni temperaturën e dhomës në 18 °C, kjo është më mirë për shëndetin tuaj.



🔄 Mbyll të gjitha rrjedhat e ajrit rreth dritareve për të mos lejuar që ajri i ftohtë të depërtojë nga të çarat.